



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government



Plani i Veprimit i Strategjisë Kombëtare të Republikës së Kosovës për
Menaxhimin e Integruar të Kufirit

Akcioni Plan Nacionalne Strategije Republike Kosova za Integrisano
Upravljanje Granicom

Action Plan of National Strategy of the Republic of Kosovo on Integrated
Border Management

Qershor –Jun-June
2013

Prishtinë-Prishtina-Pristina

Rishikuar 01-05.12.2014
28.03.2016-01.04.2016



PLANI I VEPRIMIT
I STRATEGJISË KOMBËTARE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS
PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË KUFIRIT
2013-2018

H y r j a

Qeveria e Republikës së Kosovës, në procesin e zhvillimit të Strategjisë Kombëtare për MIK, mori në konsideratë situatën socio-politike dhe sistemit juridik të Republikës së Kosovës dhe të rajonit, krahasoj përvojat e vendeve të tjera në këtë fushë, transformimin e bërë në këtë proces, pranoi dhe adoptoi në Strategjinë për MIK 2013-2018, të gjitha dokumentet strategjike si: Traktatin e Lisbonës, Udhëzimet e KE-së për MIK¹, kriteret bazë të dokumentit të Kopenhagës, Dokumentin EU Blueprint për Dogana, kërkesat në fushën e ekonomisë dhe tregtisë, standardet tjera të BE-së,², kriteret nga Udhërrëfytyruesi për Liberalizim të Vizave dhe Studimi i Fizibilitetit për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit si dhe praktikën më të mira të BE-së dhe më datë, 11.10.2013, miratoi Strategjinë Kombëtare për MIK. Duke përdorur përvojën nga praktikën më të mira që zbatohen në BE, Republika e Kosovës bën përpjekje për të tejkaluar sistemin e pengesave ekzistuese dhe në përputhje me specifikat e veta do të caktoj prioritetet për Veprimi dhe do të ndërmerri hapa gjithëpërfshirës dhe radikal për ndryshime të bashku me autoritetet kufitare në përputhje të plotë me rregullat dhe standardet e BE-së.

Strategjia Kombëtare për MIK, përfshinë një numër të madh të qëllimeve afat-shkurtra, afat-mesme dhe afat-gjatë për përmirësimin e bashkërendimit dhe bashkëpunimit brenda autoritetit/shërbimit dhe ndërmjet autoritetve dhe në mes të gjitha departamenteve dhe shërbimeve që kanë fushëVeprimi në kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit, si dhe përmirësimin e bashkëpunimit të tyre ndërkombëtar. Qëllimi i menaxhimit të integruar të kufijve është krijimi i mekanizmave për kufij të hapur për lëvizjen e personave dhe mallrave, por edhe të kontrolluar dhe të sigurt, dhe të mbyllur plotësisht për të gjitha aktivitetet penale ose çfarëdo aktiviteti tjetër që mund të rrezikojnë stabilitetin e vendit dhe rajonit në tërësi.

Bazuar në Strategjinë e Menaxhimit të Integruar të Kufirit, dhe me qëllim të zbatimit të saj, është përgatitur Plani i Veprimiit. Ky Plan i Veprimit, përmban rezultatet dhe objektivat strategjike të cilat janë zhvilluar përmes: përcaktimit të aktiviteteve të nevojshme për të arritur objektivin, institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtyre objektivave, periudhën e zbatimit, rezultatet e pritshme/dëshirueshme, personelin dhe burimet financiare, ndikimet dhe rreziqet që mund të rrezikojnë zbatimin e aktiviteteve. Ky Plan Veprimi do të dorëzohet te autoritetet kompetente të Komisionit Evropian dhe organizatat tjera për informacion.

Strategjia dhe Plani i Veprimit për MIK janë dokumente fleksibile të cilat mund të plotësohen dhe ndryshohen në vazhdimësi në aspektin e zbatimit gradual të parametrave, objektivave, veprimeve dhe proceseve të punës, në sferën e bashkëpunimit dhe koordinimit të aktiviteteve duke iu përshtatur rregullave dhe mundësive në përputhje me gjendjen në terren, interesat

¹ Konkluzionet e Këshillit të 4-5 dhjetorit 2006 mbi Menaxhimin e Integruar të Kufijve (2768 Takimi i Këshillit për Drejtësi dhe Punë të Brendshme, mbajtur në Bruksel) dhe Udhëzimet për Menaxhimin e Integruar të Kufijve në bashkëpunim e jashtëm të KE 2009,

² Katalogu i Shengenit të BE-së (rekmandimi i këshillit të BE-së 7864/09) dhe Kodi i Shengenit për Kufij (Rregullorja Nr. 562/2006 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit për krijimin e një Kodi të Komunitetit mbi rregullat që rregullojnë lëvizjen e personave përgjatë kufijve) dhe Rregullorja (KE) Nr. 810/2009 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 13 korrikut 2009 për krijimin e një Kodi të Komunitetit për Viza (Kodi i Vizave) dhe praktikën më të mira të BE-së

strategjike të Republikës së Kosovës dhe ndryshimeve brenda standardeve të BE-së. Veprimtaritë e përcaktuara në Planin e Veprimit, për shkak të afatit për zbatim mund të ndahen në afatshkurtra (deri në fund të vitit 2014), afatmesme (deri në fund të vitit 2016) dhe afatgjatë (deri në fund të vitit 2018).

Sigurisht, disa aktivitete do të vazhdojnë edhe pas vitit 2018 dhe do të trajtohen si detyra të zakonshme.

Cilësia e zbatimit me kohë dhe me sukses e të gjitha aktiviteteve që janë të përcaktuara në Planin e Veprimit 2013-2018, do të ofrojë një zbatim të plotë të Strategjisë për MIK në Republikën e Kosovës dhe do të jetë një hap i madh përpara në fushën e sigurisë kufitare dhe një impuls pozitiv për përmirësimin e imazhit të Republikës së Kosovës në relacion të ardhshëm me zbatimin e Procesit të Stabilizim-Asocimit në përputhje me rekomandimet e BE-së.

Mbështetje të konsiderueshme në përgatitjen e këtij dokumenti, kanë dhënë të gjitha ministrinë e linjës, Bordi Ekzekutiv për MIK, autoritetet kryesore të MIK-ut, njësitë koordinuese për zbatimin e udhëzimeve të KE-së për MIK dhe përfaqësues të ZKE, EULEX, ICITAP, EXBS, UNHCR, UNDP, GIZ, Projekti i Binjakëzimit për MIK dhe kundër Drogave dhe organizatat tjera ndërkombëtare. Ndihma e ofruar korrespondon me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të autoritetve/shërbimeve kufitare në seminare, punëtori dhe vizita studimore për qëllim të arsimimit, marrjes së përvojave praktike dhe krijimin e aftësive për përgatitjen e këtij dokumenti.

PËRMBAJTJA

Hyrja.....3-4

Përmbajtja.....5-7

BASHKËPUNIMI BRENDA AUTORITETIT

Policia Kufitare

Korniza ligjore 8-9

Organizimi dhe menaxhimi 9-10

Procedurat 10-12

Burimet njerëzore dhe trajnimi 12-14

Komunikimi dhe shkëmbimi i informatave 14-15

Infrastruktura dhe pajisjet 15-19

Dogana e Kosovës

Korniza ligjore 20-21

Organizimi dhe menaxhimi 21-26

Procedurat 26-28

Burimet njerëzore dhe trajnimi 29-30

Komunikimi dhe shkëmbimi i informatave 30-32

Infrastruktura dhe pajisjet 32-35

Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë së Kosovës

Korniza ligjore 36-37

Organizimi dhe menaxhimi 37-38

Procedurat 38-39

Burimet njerëzore dhe trajnimi 39-41

Komunikimi dhe shkëmbimi i informatave 41-43

Infrastruktura dhe pajisjet	43-45
BASHKËPUNIMI NDËRMJET AUTORITETEVE	
Korniza ligjore	46-47
Organizimi dhe menaxhimi	47-56
Procedurat	57-59
Burimet njerëzore dhe trajnimi	59-62
Komunikimi dhe shkëmbimi i informatave	62-64
Infrastruktura dhe pajisjet	65-70
BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR	
Policia Kufitare	
Korniza ligjore	71-74
Organizimi dhe menaxhimi	74-76
Procedurat	76-77
Burimet njerëzore dhe trajnimi	78-79
Komunikimi dhe shkëmbimi i informatave	79-82
Infrastruktura dhe pajisjet	82-83
Dogana e Kosovës	
Korniza ligjore	84-86
Organizimi dhe menaxhimi	86-87
Procedurat	87-88
Burimet njerëzore dhe trajnimi	88-89
Komunikimi dhe shkëmbimi i informatave	89-90
Infrastruktura dhe pajisjet	90
Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë	
Korniza ligjore	91
Organizimi dhe menaxhimi	92

Procedurat	93
Burimet njerëzore dhe trajnimi	94-95
Komunikimi dhe shkëmbimi i informatave	95-96
Infrastruktura dhe pajisjet	96
BASHKËPUNIMI NË FUSHËN E VIZAVE, AZILIT DHE MIGRIMIT NË KONTEKSTIN E MIK-ut.....	97-98

**BASHKËPUNIMI BRENDIA AUTORITETIT
POLICIA KUFITARE**

KORNIZA LIGJORE

OBJEKTIVI: Harmonizimi i Rregullores së brendshme të Policisë së Kosovës-Policisë Kufitare me legjislacionin në fuqi.

TREGUESIT: Rregullorja e harmonizuar dhe e vënë në zbatim.

KONTEKSTI	VEPRIMET E PROPOZUARA	AKTERËT
<p>SITUATA AKTUALE</p> <p>Të gjitha rregulloret e brendshme të Policisë së Kosovës janë të harmonizuara me legjislacionin në fuqi. Përgjegjësitë e Policisë Kufitare janë rregulluar me Ligjin e Policisë, Ligjin për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror, Ligjin për te huaj, Ligjin për Azil si dhe me Udhëzime Administrative. Në përgjithësi janë përcaktuar të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë për çdo njësi organizative dhe pozita zyrtare në Policinë Kufitare. Gjithashtu janë përpiluar dhe miratuar PSO-të konkrete për çdo aktivitet të Policisë Kufitare.</p> <p>KËRKESAT DHE PRAKTIKAT E MIRA</p> <p>Nevojiten që në vazhdimësi të përditësohet web faqja e PK me me çdo ndryshim të ligjeve, akteve nënligjore, rregulloreve të brendshme si dhe PSO-ve dhe të njoftohet personeli me ndryshimet dhe të organizohen trajnime dhe vizita lidhur me zbatimin e tyre.</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Të njoftohet personeli i PKK-ve me ç’do ndryshim të ligjeve, akteve nënligjore, rregulloreve të brendshme si dhe PSO-ve. 2. Të organizohen vizita të rregullta me qëllim të mbikëqyrjes së zbatimit të ndryshimeve ligjore. 	<p>MPB, PK/Policia Kufitare, dhe partnerët ndërkombëtar</p> <p>EXBS ICITAP EULEX UNHCR</p>

VEPRIMI 1: Të njoftohet personeli i PKK-ve me çdo ndryshim të ligjeve, akteve nënligjore, rregulloreve të brendshme si dhe PSO-ve.

AKTIVITETET:

1. Përditësimi i web faqes së PK me çdo ndryshim të ligjeve, akteve nënligjore si dhe PSO-ve.

PËRPARËSIA: E mesme.

REZULTATI I PRITUR: Ngritja e efikasitetit në punë.

TREGUESIT: Web faqja e përditësuar dhe personeli i njoftuar

AUTORITETI PËRGJEGJËS: Policia e Kosovës-Policia Kufitare.

AKTERËT E PËRFSHIRË MPB, PK

KOSTOT PËR GRUPET KRYESORE TË INTERESIT

Autoriteti: Policia e Kosovës-Policia Kufitare,

Kostot; Kosto administrative, vlera e përafërt 3,000.00 euro (për 3 vite)		
Përfitimet; Ngritja e efikasitetit në punë, njohja më e mirë e legjislacionit në fuqi dhe zbatim praktik.		
KOHËZGJATJA: Në vazhdimësi		
KALENDARI I PROPOZUAR: Dhjetor 2016 .		
RREZIQET: Pengesat e ndryshme administrative.		
VEPRIMI 2: Të organizohen vizita të rregullta me qëllim të mbikëqyrjes së zbatimit të ndryshimeve ligjore.		
AKTIVITETET:		
<ol style="list-style-type: none"> 1. Planifikimi i orarit të vizitave 2. Organizimi i vizitave 3. Raportimi i të gjeturave 		
PËRPARËSIA: E mesme		
REZULTATI I PRITUR: Ngritja e efikasitetit në punë		
TREGUESIT: Aktet ligjore dhe nënligjore të aprovuara dhe të vëna në zbatim.		
AUTORITETI PËRGJEGJËS: Policia e Kosovës-Policia Kufitare		
AKTERËT E PËRFSHIRË: MPB, PK, EXBS, ICITAP, EULEX, UNHCR.		
KOSTOT PËR GRUPET KRYESORE TË INTERESIT		
Autoriteti: Policia e Kosovës-Policia Kufitare,		
Kostot; Kosto administrative vlera e përafërt 4,000.00 euro (për 3 vite)		
Përfitimet; Ngritja e efikasitetit në punë, njohja më e mirë e legjislacionit në fuqi dhe zbatim praktik.		
KOHËZGJATJA: Në vazhdimësi		
KALENDARI I PROPOZUAR: Dhjetor 2016.		
RREZIQET: Pengesat e ndryshme administrative.		
ORGANIZIMI DHE MENAXHIMI		
OBJEKTIVI 1: Marrja e përgjegjësisë nga KFOR-i për vijën e gjelbër dhe të kaltër në kufirin me Republikën e Serbisë.		
TREGUESIT: Mbikëqyrja e vijës së gjelbër dhe kaltër nga PK–Policia Kufitare.		
KONTEKSTI	VEPRIMET E PROPOZUARA	AKTERËT
SITUATA AKTUALE Aktualisht kompetencat në kontrollin dhe mbikëqyrjen e vijës së gjelbër në kufirin me Shqipërinë, Maqedoninë dhe Malin e Zi janë në kompetencë të plotë të Policisë Kufitare të Republikës së Kosovës. Me autoritetet policore të Shqipërisë dhe Maqedonisë realizohen patrullime të përbashkëta, kurse me autoritetet e Malit të Zi patrullime të sinkronizuara. Sa i përket patrullimeve me KFOR, DK ato zhvillohen në vazhdimësi bazuar në planet operative.	<ol style="list-style-type: none"> 1. Gjetja dhe negociimi i modaliteteve të marrjes së kompetencave prej KFOR-it. 	MPB, KFOR, PK-Policia Kufitare, EULEX. Partnerët ndërkombëtar.
KËRKESAT DHE PRAKTIKAT E MIRA Bazuar në legjislacionin në fuqi dhe standardet e		

<p>secilit shtet demokratik dhe të zhvilluar, kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit duhet ta bëjë Policia Kufitare. Duhet të gjenden modalitetet e marrjes së kompetencave prej KFOR-it në kufirin me Republikën e Serbisë.</p>		
<p>VEPRIMI 1: Gjetja dhe negociimi i modaliteteve të marrjes së kompetencave prej KFOR-it</p>		
<p>AKTIVITETET</p>		
<ol style="list-style-type: none"> 1. Vlerësimi i gjendjes së sigurisë në vijën e gjelbër dhe kaltër në kufirin me Republikën e Serbisë. 2. Vazhdimi i takimeve të rregullta me KFOR 3. Arritja e marrëveshjes për marrje të kompetencave për mbikëqyrje të kufirit me Republikën e Serbisë. 4. Pranim/dorëzimi i përgjegjësi për mbikëqyrje të kufirit me Republikën e Serbisë. 		
<p>PËRPARËSIA: E lartë.</p>		
<p>REZULTATI I PRITUR: Mbikëqyrja e vijës kufitare me Republikën e Serbisë nga Policia Kufitare.</p>		
<p>TREGUESIT: Marrja e përgjegjësi për mbikëqyrjen e vijës së gjelbër-kaltër të Kufirit me Republikën e Serbisë.</p>		
<p>AUTORITETETI PËRGJEGJËS: PK-Policia Kufitare.</p>		
<p>AKTERËT E PËRFSHIRË: MPB, PK-Policia Kufitare, KFOR-i, EULEX-i.</p>		
<p>KOSTOT PËR GRUPET KRYESORE TË INTERESIT</p>		
<p>Autoriteti: PK – Policia Kufitare.</p>		
<p>Kostot: Të parapara në buxhetin e PK-së për transfer të përgjegjësi 300,000.00 euro (3 vite)</p>		
<p>Përfitimet: Marrja e përgjegjësi për mbikëqyrjen e kufirit.</p>		
<p>KOHËZGJATJA: Sipas planifikimeve të KFOR-it.</p>		
<p>KALENDARI I PROPOZUAR: Në vazhdimësi.</p>		
<p>RREZIQET: Gjendja e sigurisë në vijën kufitare me Republikën e Serbisë.</p>		
<p>PROCEDURAT</p>		
<p>OBJEKTIVI 1: Avancimi i bashkëpunimit mes Departamenteve në kuadër të Policisë së Kosovës.</p>		
<p>TREGUESIT: Hartimi dhe vënia në zbatim e PSO-ve nga dy e më shumë Departamente.</p>		
<p>KONTEKSTI</p>	<p>VEPRIMET E PROPOZUARA</p>	<p>AKTERËT</p>
<p>SITUATA AKTUALE Ekziston një bashkëpunim i mirë, megjithatë është e nevojshme të ngritët ende ky bashkëpunim, duke marrë për bazë detyrat edhe përgjegjësitë e përbashkëta që dalin nga dokumentet strategjike dhe aktet tjera administrative. Është aprovuar UA për bashkëpunim brenda autoritetit si dhe një numër i PSO-ve.</p> <p>KËRKESAT DHE PRAKTIKAT E MIRA Është e nevojshme që të bëhet ndërlidhja e Analizës së Riskut dhe analizave tjera me</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Ndërlidhja e Analizës së Riskut dhe analizave tjera me produktet dhe vlerësimet strategjike të DIA-së, analizën strategjike vjetore dhe raporti i vlerësimit të kërcënimeve nga krimi i organizuar dhe krimet e rënda (SOCTA). 2. Organizimi i takimeve të përbashkëta të rregullta dhe sipas nevojës në nivelin 	<p>MPB Policia e Kosovës, (Departamentet)</p>

<p>produktet dhe vlerësimet strategjike të DIA-së, analizën strategjike vjetore dhe raportin e vlerësimit të kërcënimeve nga krimi i organizuar dhe krimet e rënda (SOCTA).</p> <p>Po ashtu, duhet të organizohen takime të përbashkëta të rregullta dhe sipas nevojës në nivelin operacional dhe njëkohësisht të organizohen operacione të përbashkëta me qëllim të ngritjes së bashkërendimit të aktiviteteve.</p>	<p>operacional.</p> <p>3. Organizimi i operacioneve të përbashkëta.</p>	
<p>VEPRIMI 1: Ndërlidhja e Analizës së Riskut dhe analizave tjera me produktet dhe vlerësimet strategjike të DIA-së, analizën strategjike vjetore dhe raporti i vlerësimit të kërcënimeve nga krimi i organizuar dhe krimet e rënda (SOCTA).</p>		
<p>AKTIVITETET</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Vlerësimi i gjendjes aktuale në sferën e bashkëpunimit në fushën e analizës së riskut. 2. Hartimi i PSO-së dhe akteve tjera administrative të përbashkëta. 3. Aprovimi dhe zbatimi i tyre në praktikë. 		
<p>PËRPARËSIA: E lartë.</p>		
<p>REZULTATI I PRITUR: Ngritja e bashkëpunimit dhe bashkërendimi të aktiviteteve të përbashkëta.</p>		
<p>TREGUESIT : PSO-të dhe aktet tjera administrative të hartuara dhe të vëna në zbatim.</p>		
<p>AUTORITETI PËRGJEGJËS: Policia e Kosovës.</p>		
<p>AKTERËT E PËRFSHIRË: MPB, PK, (Departamentet).</p>		
<p>KOSTOT PËR GRUPET KRYESORE TË INTERESIT</p>		
<p>Autoriteti: Policia e Kosovës.</p>		
<p>Kostot: Të parapara në buxhetin e autoritetit 3,000.00 euro (3 vite).</p>		
<p>Përfitimet: Rritja e efikasitetit të punës.</p>		
<p>KOHËZGJATJA: Në vazhdimësi.</p>		
<p>KALENDARI I PROPOZUAR: Në vazhdimësi.</p>		
<p>RREZIQET: Pengesat e ndryshme administrative.</p>		
<p>VEPRIMI 2: Organizimi i takimeve të përbashkëta të rregullta dhe sipas nevojës në nivelin operacional.</p>		
<p>AKTIVITETET:</p>		
<ol style="list-style-type: none"> 1. Mbajtja e takimeve të rregullta dhe ad hok 2. Raportimi për takimet dhe vendimet e marra. 		
<p>PËRPARËSIA: E lartë.</p>		
<p>REZULTATI I PRITUR: Ngritja e bashkëpunimit dhe bashkërendimit të aktiviteteve të përbashkëta.</p>		
<p>TREGUESIT : Takimet e mbajtura dhe raportet e dërgura.</p>		
<p>AUTORITETI PËRGJEGJËS: Policia e Kosovës.</p>		
<p>AKTERËT E PËRFSHIRË: PK, (Departamentet).</p>		
<p>KOSTOT PËR GRUPET KRYESORE TË INTERESIT</p>		
<p>Autoriteti: Policia e Kosovës.</p>		
<p>Kostot: Administrative</p>		
<p>Përfitimet: Rritja e efikasitetit të punës.</p>		
<p>KOHËZGJATJA: Në vazhdimësi</p>		

KALENDARI I PROPOZUAR: Në vazhdimësi		
RREZIQET: Pengesat e ndryshme administrative		
VEPRIMI 3: Organizimi i operacioneve të përbashkëta		
AKTIVITETET:		
<ol style="list-style-type: none"> 1. Planifikimi i operacioneve të përbashkëta 2. Realizimi i operacioneve të përbashkëta 3. Raportimi për rezultatet e operacioneve të përbashkëta. 		
PËRPARËSIA: E lartë.		
REZULTATI I PRITUR: Ngritja e efikasitetit		
TREGUESIT: Numri i operacioneve të realizuara dhe raportet e rezultateve .		
AUTORITETI PËRGJEGJËS: Policia e Kosovës.		
AKTERËT E PËRFSHIRË: PK, (Departamentet).		
KOSTOT PËR GRUPET KRYESORE TË INTERESIT		
Autoriteti: Policia e Kosovës.		
Kostot: Të parapara në buxhetin e autoritetit 7 ,000.00 euro (3 vite).		
Përfitimet: Rritja e efikasitetit të punës.		
KOHËZGJATJA: Në vazhdimësi		
KALENDARI I PROPOZUAR: Në vazhdimësi		
RREZIQET: Pengesat e ndryshme materiale dhe administrative		
BURIMET NJERËZORE DHE TRAJNIMI		
OBJEKTIVI 1: Ngritja e kapaciteteve dhe menaxhimit të resurseve njerëzore.		
TREGUESIT: Manuali i trajnimit, menaxhimi i burimeve njerëzore nga PK- ja.		
KONTEKSTI	VEPRIMET E PROPOZUARA	AKTERËT
<p>SITUATA AKTUALE</p> <p>Mungesa e personelit të mjaftueshëm për mbikëqyrjen e kufirit sipas strukturës së re organizative. Është përgatitur manuali i veçantë për trajnimin e Policisë Kufitare i cili aplikohet nga Departamenti i Trajnimeve.</p> <p>KËRKESAT DHE PRAKTIKAT E MIRA</p> <p>Në vazhdimësi të bëhet rifreskimi i manualit të trajnimit më qëllim që të jemi në trendet e zhvillimit të praktikave më të mira për parandalimin e dukurive kriminale dhe poashtu të bëhet plotësimi me personel të mjaftueshëm për mbikëqyrjen e kufirit si dhe të organizohen trajnime të vazhdueshme për Policinë Kufitare në fushën e:</p> <p>MIK-ut, kundër krimit të organizuar,</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Rifreskimi i manualit të trajnimit më qëllim të zhvillimit të praktikave më të mira për parandalimin e dukurive kriminale. 2. Organizimi i trajnimeve të përbashkëta në fushën e: MIK-ut, kundër krimit të organizuar, trafikimit me qenie njerëzore, terrorizmit, drogave, trajtimit të informatorëve, agjentëve të mbuluar, togjeve patrulluese me njësitë mbështetëse operative. 3. Rishikimi, azhurnimi, hartimi i planprogramit trajnues të Policisë Kufitare duke përfshirë trajnimet themelore, të 	<p>MPB, Policia e Kosovës, Policia Kufitare, Departamenti i Trajnimeve,</p> <p>ICITAP, IOM, UNHCR EXBS dhe EULEX</p>

<p>trafikimit me qenie njerëzore, terrorizmit, drogave, trajtimit të informatorëve, agjentëve të mbluar, togjeve patrulluese me njësitë mbështëse operative.</p>	<p>avancuara dhe specializuara dhe shfrytëzimi i burimeve të brendshme (TOT) për ofrimin e trajnimeve në shërbim.</p>	
<p>VEPRIMI 1: Rifreskimi i manualit të trajnimit më qëllim të zhvillimit të praktikave më të mira për parandalimin e dukurive kriminale.</p>		
<p>AKTIVITETET</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Vlerësimi i nevojave për rifreskim të manualit të trajnimit. 2. Mbajtja e trajnimeve të përgjithshme dhe specializuara. 		
<p>PËRPARËSIA: E mesme.</p>		
<p>REZULTATI I PRITUR: Manuali i rifreskuar.</p>		
<p>TREGUESIT: Praktikant e parapara</p>		
<p>AUTORITETI PËRGJEGJËS: Policia Kufitare.</p>		
<p>AKTERËT E PËRFSHIRË:MPB, PK-Policia Kufitare, ICITAP, EXBS, IOM, UNHCR dhe EULEX</p>		
<p>KOSTOT PËR GRUPET KRYESORE TË INTERESIT</p>		
<p>Autoriteti: PK</p>		
<p>Kostot: Të parapara në buxhetin e autoritetit si dhe donacioneve 7,500.00 euro (3 vite)</p>		
<p>Përfitimet: Profesionalizmi dhe ngritja e efikasitetit</p>		
<p>KOHËZGJATJA: Në vazhdimësi.</p>		
<p>KALENDARI I PROPOZUAR: Në vazhdimësi.</p>		
<p>RREZIQET: Pengesat e ndryshme materiale dhe administrative</p>		
<p>VEPRIMI 2. Organizimi i trajnimeve të përbashkëta në fushën e: MIK-ut, kundër krimit të organizuar, trafikimit me qenie njerëzore, terrorizmit, drogave, trajtimit të informatorëve, agjentëve të mbuluar, togjeve patrulluese me njësitë mbështëse operative.</p>		
<p>AKTIVITETET</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Vlerësimi i nevojave për trajnime të përbashkëta. 2. Mbajtja e trajnimeve të përgjithshme dhe të specializuara. 		
<p>PËRPARËSIA: E mesme.</p>		
<p>REZULTATI I PRITUR: Ngritja e profesionalizmit</p>		
<p>TREGUESIT: Personel i trajnuar</p>		
<p>AUTORITETI PËRGJEGJËS: Policia e Kosovës</p>		
<p>AKTERËT E PËRFSHIRË: MPB, PK-Policia Kufitare, ICITAP, EXBS, IOM, UNHCR dhe EULEX</p>		
<p>KOSTOT PËR GRUPET KRYESORE TË INTERESIT</p>		
<p>Autoriteti: PK</p>		
<p>Kostot: Të parapara në buxhetin e autoritetit si dhe donacione 15,000.00 euro (3 vite)</p>		
<p>Përfitimet: Profesionalizmi dhe ngritja e efikasitetit</p>		
<p>KOHËZGJATJA: Në vazhdimësi</p>		
<p>KALENDARI I PROPOZUAR: Në vazhdimësi</p>		
<p>RREZIQET: Pengesat e ndryshme materiale dhe administrative</p>		

VEPRIMI 3: Rishikimi, azhurnimi, hartimi i planprogramit trajnues të Policisë Kufitare duke përfshirë trajnimet themelore, të avancuara dhe specializuara dhe shfrytëzimi i burimeve të brendshme (TOT) për ofrimin e trajnimeve në shërbim.

AKTIVITETET

1. Rishikimi dhe azhurnimi i planprogramit trajnues
2. Hartimi i planprogramit trajnues
3. Shfrytëzimi i burimeve të brendshme (TOT) për ofrimin e trajnimeve në shërbim.
4. Mbajtja e trajnimeve.

PËRPARËSIA: E mesme.

REZULTATI I PRITUR: Ngritja e profesionalizmit

TREGUESIT: Programi i rishikuar, i hartuar dhe personeli i trajnuar

AUTORITETI PËRGJEGJËS: Policia e Kosovës

AKTERËT E PËRFSHIRË: MPB, PK-Policia Kufitare, ICITAP, EXBS, IOM, UNHCR dhe EULEX

KOSTOT PËR GRUPET KRYESORE TË INTERESIT

Autoriteti: PK

Kostot: Të prapara në buxhetin e autoritetit si dhe donacione 75,000.00 euro (3 vite).

Përfitimet: Profesionalizmi dhe ngritja e efikasitetit

KOHËZGJATJA: Në vazhdimësi

KALENDARI I PROPOZUAR: Në vazhdimësi

RREZIQET: Pengesat e ndryshme materiale dhe administrative

KOMUNIKIMI DHE SHKËMBIMI I INFORMATAVE

OBJEKTIVI 1. Avancimi i sistemit të komunikimit për dhënie- shkëmbimin e informacioneve.

TREGUESIT: Sistemi aktual i komunikimit.

KONTEKSTI	VEPRIMET E PROPOZUARA	AKTERËT
<p>SITUATA AKTUALE Momentalisht është një sistem funksional i komunikimit në Policinë Kufitare i cili mbulon të gjitha PKK-të dhe vijën gjelbër sipas strukturës organizative dhe hierarkisë ekzistuese.</p> <p>KËRKESAT DHE PRAKTIKAT E MIRA Të zhvillohet një sistem i integruar dhe funksional i komunikimit në tërë Policinë Kufitare në vazhdimësi për shkëmbimin e informatave. Për të arritur këtë kërkesë duhet të eliminohen problemet harduerike dhe softwerike në funksionim të sistemit BMS, më qëllim që sistemi t'i përmbush standardet funksionale të kërkuara;</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Të eliminohen problemet harduerike dhe softwerike në funksionim të sistemit BMS, më qëllim që sistemi t'i përmbush standardet funksionale të kërkuara. 2. Mirëmbajtja e sistemit BMS. 	<p>PK,</p> <p>ZBE ICITAP, EXBS, EULEX,</p>

VEPRIMI 1: Të eliminohen problemet harduerike dhe softwerike në funksionim të sistemit BMS, më qëllim që sistemi t'i përmbush standardet funksionale të kërkuara.

AKTIVITETET:		
1. Angazhimi i ekspertëve në identifikimin e problemeve harduerike dhe softwerike në funksionim të sistemit BMS dhe nevojave për avancim		
2. Raporti mbi të gjeturat e gjendjes së sistemit		
3. Implementimi i të gjeturave		
PËRPARËSIA: E lartë.		
REZULTATI I PRITUR: Komunikim i shpejtë dhe efikas në të gjitha nivelet.		
TREGUESIT: Sistemi i integruar i komunikimit dhe rezultatet konkrete.		
AUTORITETI PËRGJEGJËS: PK		
AKTERËT E PËRFSHIRË: PK, DSHM, ZBEK, ICITAP, EULEX, EXBS, IPA.		
KOSTOT PËR GRUPET KRYESORE TË INTERESIT		
Autoriteti: Policia Kufitare.		
Kosto: Të parapara në buxhetin e autoritetit 75 ,000.00 euro (3 vite) .		
Përfitimet: Komunikim dhe shkëmbim i informatave efikase në PK.		
KOHËZGJATJA: Në vazhdimësi.		
KALENDARI I PROPOZUAR: Në vazhdimësi.		
RREZIQET: Ngecjet në funksionalizimin e sistemit të komunikimit dhe shkëmbimit të informatave.		
VEPRIMI 2: Mirëmbajtja e sistemit BMS.		
AKTIVITETET:		
1.Vlerësimi i funksionimit të sistemit 2.Krijimi i aplikacioneve të reja sipas kërkesave të PK.		
PËRPARËSIA: E lartë.		
REZULTATI I PRITUR: Eliminimi i mangësive të sistemit aktual dhe mirëmbajtja.		
TREGUESIT: Sistemi funksional.		
AUTORITETI PËRGJEGJËS: PK		
AKTERËT E PËRFSHIRË: PK, ICITAP, EXBS, ZBE.		
KOSTOT PËR GRUPET KRYESORE TË INTERESIT		
Autoriteti: PK dhe Policia Kufitare.		
Kosto: Të parapara në buxhetin e autoritetit 384 ,000.00 euro (3 vite).		
Përfitimet: Sistem funksional i kontrollit të hyrje / daljeve dhe shkëmbim të informatave.		
KOHËZGJATJA: Në vazhdimësi.		
KALENDARI I PROPOZUAR: Në vazhdimësi.		
RREZIQET:		
Mos funksionimi i plotë i sistemit.		
Pengesat e ndryshme financiare, administrative dhe teknike.		
INFRASTRUKTURA DHE PAJISJET		
OBJEKTIVI 1: Përmirësimi i infrastrukturës ekzistuese dhe ndërtimi i objekteve të reja në PKK-të e përbashkëta.		
TREGUESIT: Zbatimi i projekteve të hartuara.		
KONTEKSTI	VEPRIMET E PROPOZUARA	AKTERËT

<p>SITUATA AKTUALE</p> <p>Kushtet rreth infrastrukturës rrugore, objekteve dhe pajisjeve janë përmirësuar dukshëm si në PKK, ashtu edhe në togjet patrulluese në përjashtim të PKK-ve me Malin e Zi dhe Serbinë, ku të gjitha aktivitetet policore kryhen në kontejnerë. Është themeluar njësitë K-9 me infrastrukturën përcjellëse.</p> <p>KËRKESAT DHE PRAKTIKAT E MIRA</p> <p>Ndërtimi i objekteve të reja dhe të përbashkëta në PKK, si dhe rregullimi i infrastrukturës së vijës kufitare (vendosja e kullave vrojtuese, shenjave paralajmëruese, trasimi i rrugës dhe bllokimi i rrugëve të pa autorizuara) për krijimin e kushteve më të mira të punës dhe ngritjes së efikasitetit si kualitetit dhe shërbimin ndaj qytetarëve.</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Të përmirësohet infrastruktura në PKK–të në kufirin me Republikën e Serbisë deri sa të ndërtohen 6 PKK e reja. 2. Të ndërtohen PKK të përbashkëta me Republikën e Maqedonisë dhe Republikën e Malit të Zi. 3. Renovimi i objekteve të SPMK dhe PKK-ve. <p>Ndërtimi i dy PKK të reja të përbashkëta me Republikën e Serbisë në PKK Kapi dhe PKK Izvori.</p>	<p>MPB, MF, MMPH, MAPL Policia e Kosovës/ Policia Kufitare, EULEX ICITAP KE ZBE</p>
<p>VEPRIMI 1: Të përmirësohet infrastruktura në PKK–të në kufirin me Republikën e Serbisë deri sa të ndërtohen 6 PKK e reja.</p>		
<p>AKTIVITETET:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Mirëmbajtja e infrastrukturës ekzistuese në PKK 2. Ndërtimi i objekteve të reja dhe të përbashkëta sipas stardadeve të BE-së. 		
<p>PËRPARËSIA: E lartë.</p>		
<p>REZULTATI I PRITUR: Objektet e ndërtuara dhe funksionale.</p>		
<p>TREGUESIT: Projektet e hartuara dhe të zbatuara.</p>		
<p>AUTORITETI PËRGJEGJËS: PK</p>		
<p>AKTERËT E PËRFSHIRË: MPB, Policia e Kosovës-Policia Kufitare, MF, MMPH, MAPL, ICITAP, EULEX, KE, ZBE.</p>		
<p>KOSTOT PËR GRUPET KRYESORE TË INTERESIT</p> <p>Autoriteti: PK.</p> <p>Kosto: Projekte të financuara nga BE-ja si dhe nga buxheti për investime kapitale:</p> <p>Përfitimet: Përmirësimi i kushteve optimale për punë.</p>		
<p>KOHËZGJATJA: Në vazhdimësi.</p>		
<p>KALENDARI I PROPOZUAR: Në vazhdimësi.</p>		
<p>RREZIQET</p> <p>Mos aprovimi i planeve dhe projekteve, Pengesat administrative dhe Mungesa e mjeteve buxhetore.</p>		
<p>VEPRIMI 2: Të ndërtohen PKK të e përbashkëta me Republikën e Maqedonisë dhe Republikën e Malit të Zi.</p>		
<p>AKTIVITETET:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Ndërtimi i objekteve të reja dhe të përbashkëta sipas stardadeve të BE-së. 		
<p>PËRPARËSIA: E lartë.</p>		

REZULTATI I PRITUR: Objektet e ndërtuara dhe funksionale.
TREGUESIT: Projektet e hartuara dhe të zbatuara.
AUTORITETI PËRGJEGJËS: PK
AKTERËT E PËRFSHIRË: MPB, Policia e Kosovës-Policia Kufitare, MF, MMPH, MI, MZHE, MAPL, ICITAP, EXBS, KE,ZBE.
KOSTOT PËR GRUPET KRYESORE TË INTERESIT Autoriteti: PK. Kosto: Projekte të financuara nga BE-ja si dhe nga buxheti për investime kapitale: PKK Stanqiq-Bellanovc 1,200,000.00 euro donacion KE dhe nga buxheti për investime kapitale: PKK Kuqishtë-Kotillovo kostoja do të negociohet me KE dhe nga buxheti për investime kapitale Përfitimet: Kushte optimale për punë.
KOHËZGJATJA: Në vazhdimësi.
KALENDARI I PROPOZUAR: Në vazhdimësi.
RREZIQET Mos aprovimi i planeve dhe projekteve, Pengesat administrative dhe Mungesa e mjeteve buxhetore.
VEPRIMI 3: Renovimi i SPMK dhe PKK-ve
AKTIVITETET: Renovimi i objekteve.
PËRPARËSIA: E mesme.
REZULTATI I PRITUR: Objektet e renovuara dhe funksionale.
TREGUESIT: Projektet e hartuara dhe të zbatuara.
AUTORITETI PËRGJEGJËS: PK
AKTERËT E PËRFSHIRË: MPB, Policia e Kosovës-Policia Kufitare, MF, MMPH, MI, MZHE, MAPL, ICITAP, EXBS, KE, ZBE.
KOSTOT PËR GRUPET KRYESORE TË INTERESIT Autoriteti: PK. Kosto: Projekte të financuara nga buxheti për investime kapitale 100,000.00 euro (për 3 vite) Përfitimet: Kushte optimale për punë.
KOHËZGJATJA: Në vazhdimësi.
KALENDARI I PROPOZUAR: Në vazhdimësi.
RREZIQET Mos aprovimi i planeve dhe projekteve, Pengesat administrative dhe Mungesa e mjeteve buxhetore
VEPRIMI I 4; Ndërtimi i dy PKK te reja te përbashkëta me Republikën e Serbise ne PKK Kapi dhe PKK Izvori
AKTIVITETET: <ul style="list-style-type: none"> • Hartimi i projektit • Ndërtimi i objekteve të reja dhe të përbashkëta sipas stardadeve të BE-së.

PËRPARËSIA: E mesme		
REZULTATI I PRITUR: Objektet e ndërtuara dhe funksionale.		
TREGUESIT: Objektet e ndërtuar.		
AUTORITETI PËRGJEGJËS: PK		
AKTERËT E PËRFSHIRË: MPB, Policia e Kosovës-Policia Kufitare, IPA		
KOSTOT PËR GRUPET KRYESORE TË INTERESIT		
Kosto: Projekte të financuara nga BE-ja si dhe nga buxheti për investime kapitale: PKK Kapi 100,000.00 euro donacion KE dhe nga buxheti për investime kapitale		
Përfitimet: Kushte optimale për punë.		
KOHËZGJATJA: Në vazhdimësi.		
KALENDARI I PROPOZUAR: Shtator 2016		
RREZIQET		
Mos aprovimi i planeve dhe projekteve, Pengesat administrative dhe Mungesa e mjeteve buxhetore		
OBJEKTIVI 2: Sigurimi i pajisjeve të nevojshme për Policinë Kufitare		
TREGUESIT: Pajisjet e siguruar në përputhje me standardet e BE-së.		
KONTEKSTI	VEPRIMET E PROPOZUARA	AKTERËT
<p>SITUATA AKTUALE Momentalisht Policia e Kosovës- Policia Kufitare posedon pajisje të cilat i ndihmojnë në zbatimin e ligjit dhe ruajtjen e rendit dhe sigurisë. Sidoqoftë këto pajisje ekzistuese nuk i plotësojnë të gjitha nevojat që ka Policia e Kosovës-Policia Kufitare.</p> <p>KËRKESAT DHE PRAKTIKAT E MIRA Duhet të sigurohen pajisje shtesë të cilat do ta lehtësonin punën e PK-së-Policisë Kufitare në zbatimin e rendit dhe ligjit që do të garantonin ngritjen e efikasitetit në kryerjen e detyrave të përditëshme. Nevojë imediate është instalimi i sistemit TVQM (CCTV) dhe LAT (ANPR) në të gjitha PKK dhe të rritet në maksimum përdorimi i pajisjeve.</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Furnizimi i vazhdueshëm i PK-Policisë Kufitare me pajisjet moderne dhe të sofistikuara të nevojshme si dhe mirëmbajtja e tyre. 2. Të rritet përdorimi me efikas i pajisjeve si dhe inspektimi i tyre ad hok dhe kontrollave të rregullta dhe përcaktimi i përgjegjësive mbi përdorimi sipas UA dhe PSO në fuqi. 	<p>MPB,MF, PK-Policia Kufitare, ICITAP, EXBS, EULEX KE, ZBE.</p>
VEPRIMI 1: Furnizimi i vazhdueshëm i PK-Policisë Kufitare me pajisjet moderne dhe të sofistikuara të nevojshme si dhe mirëmbajtja e tyre.		
AKTIVITETET:		
<ol style="list-style-type: none"> 1. Vlerësimi i nevojave për pajisje shtesë. 2. Hartimi i planit të investimit. 3. Blerja, instalimi/funksionalizimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve. 		
PËRPARËSIA: E lartë.		
REZULTATI I PRITUR: Pajisjet e siguruar dhe funksionale.		

TREGUESIT: Planet e hartuara dhe furnizimi me pajisje.
AUTORITETI PËRGJEGJËS: PK
AKTERËT E PËRFSHIRË MPB, Policia e Kosovës-Policia Kufitare, MF, ICITAP, EXBS, EULEX, KE, IPA,
KOSTOT PËR GRUPET KRYESORE TË INTERESIT Autoriteti: PK. Kostot: Të parapara në buxhetin për investime kapitale të PK dhe donacionet e mundshme. - Pajisje të specializuara për Policinë Kufitare 632, 700. 00 euro (tri vite) - Pajisje të avansura për mbikëqyrje dhe kontroll të kufirit shtetëror 367,000.00 euro (tri vite) Përfitimet: Ngritja e efikasitetit dhe efektivitetit në punë.
KOHËZGJATJA: Në vazhdimësi.
KALENDARI I PROPOZUAR: Në vazhdimësi.
RREZIQET: Mos aprovimi i planeve dhe projekteve dhe mungesa e mjeteve buxhetore.
VEPRIMI 2: Të rritet përdorimi më efikas i pajisjeve si dhe inspektimi i tyre ad hok dhe kontrollave të rregullta dhe përcaktimi i përgjegjësive mbi përdorimi sipas UA dhe PSO në fuqi.
AKTIVITETET: 1. Zbatimi praktik i përdorimit të pajisjeve 2. Raportimi mbi përdorimin e pajisjeve
PËRPARËSIA: E mesme.
REZULTATI I PRITUR: Pajisjet e përdorura dhe funksionale
TREGUESIT: Përdorimi optimal i pajisjeve dhe raportimi mbi përdorimin e tyre.
AUTORITETI PËRGJEGJËS: PK
AKTERËT E PËRFSHIRË MPB, Policia e Kosovës-Policia Kufitare, ICITAP, EXBS, EULEX,
KOSTOT PËR GRUPET KRYESORE TË INTERESIT Autoriteti: PK. Kostot: Administrative Përfitimet: Ngritja e efikasitetit dhe efektivitetit në punë.
KOHËZGJATJA: Në vazhdimësi
KALENDARI I PROPOZUAR: Në vazhdimësi.
RREZIQET: Mos përdorimi dhe mos raportimi mbi përdorimin e pajisjeve.

DOGANA E KOSOVËS

KORNIZA LIGJORE

OBJEKTIVI 1: Harmonizimi i infrastrukturës ligjore konform EU Acquis.

TREGUESIT: Kodi Doganor dhe i Akcizave i harmonizuar dhe funksional.

KONTEKSTI

SITUATA AKTUALE

Dogana e Kosovës funksionon në bazë të Kodit Doganor dhe të Akcizave nr. 03/L-109 dhe Ligjeve të aplikueshme të Republikës së Kosovës. Ky legjislacioni doganor në masë të madhe ë madhe është në përputhje me legjislacionin e BE-së (EU Acquis). Gjatë aplikimit është vërejtur nevoja e ndryshimit dhe plotësimit të KDAK, konform rekomandimeve të BE-së të adresuara në Raportin e progresit të KE.

KËRKESAT DHE PRAKTIKAT E MIRA

Të aplikohen standardet dhe praktikat e mira të BE-së në këtë fushë si dhe të përmbushen objektivat e dala nga EU-Blueprint. Në vazhdimësi të bëhet rifreskimi i Kodit Doganor dhe të Akcizës, UA dhe PSO-ve.

VEPRIMET E PROPOZUARA

1. Miratimi i Kodit Doganor dhe Akcizës dhe Ligjit për Masat Doganore për Mbrojtjen e Pronësisë Intelektuale.
2. Të nxirren Udhëzimet Administrative si dhe PSO-të.

AKTERËT

Kuvendi i Kosovës,
MF,
DK,

VEPRIMI 1: Miratimi i Kodit Doganor dhe Akcizës dhe Ligjit për Masat Doganore për Mbrojtjen e Pronësisë Intelektuale.

AKTIVITETET;

1. Miratimi i Kodit Doganor dhe të Akcizave dhe
2. Miratimi i Ligjit për Masat Doganore për Mbrojtjen e Pronësisë Intelektuale.

PËRPARËSIA: E lartë.

REZULTATI I PRITUR: Zbatimi i KDAK-së.

TREGUESIT: KDAK i miratuar.

AUTORITETI PËRGJEGJËSE: MF, DK.

AKTERËT E PËRFSHIRË: Ministria e Financave dhe Dogana e Kosovës.

KOSTOT PËR GRUPET KRYESORE TË INTERESIT

Autoriteti: DK

Kostot: Të parapara në buxhetin e autoritetit: 3 .000 euro për 3 vite

Përfitimet: Kodi Doganor dhe i Akcizave i harmonizuar, funksional dhe në harmoni me praktikat e BE-së.

KOHËZGJATJA: Dhjetor 2016

KALENDARI I PROPOZUAR: Pika një brenda çerekut të katërt 2016.

Pika dy: 6 muaj nga dita e aprovimit dhe publikimit të Kodit Doganor.

Pika 3: 6 muaj mbas aprovimit dhe publikimit të UA implementuese		
RREZIQET Pengesat e ndryshme administrative.		
VEPRIMI 2; Të nxirren Udhëzimet Administrative si dhe PSO-të		
AKTIVITETET;		
1. Formimi i grupit punes		
2. Hartimi i UA dhe PSO-ve		
3. Miratimi dhe zbatimi i UA dhe PSO-ve		
PËRPARËSIA: E mesme		
REZULTATI I PRITUR: Ngritja e efikasitetit në punë		
TREGUESIT: UA dhe PSO të e miratuara.		
AUTORITETI PËRGJEGJËSE: MF, DK.		
AKTERËT E PËRFSHIRË: Ministria e Financave dhe Dogana e Kosovës		
KOSTOT PËR GRUPET KRYESORE TË INTERESIT		
Autoriteti: DK		
Kostot: Administrative		
Përfitimet: Kodi Doganor dhe i Akcizave i harmonizuar, funksional dhe në harmoni me praktikat e BE-së.		
KOHËZGJATJA: Në vazhdimësi		
KALENDARI I PROPOZUAR: Dhjetor 2016		
RREZIQET: Pengesat e ndryshme administrative.		
ORGANIZIMI DHE MENAXHIMI		
OBJEKTIVI 1. Avancimi i mëtutjeshëm i organizimit dhe menaxhimit të DK, sipas standardeve të EU-Blueprint		
TREGUESIT: Strukturat e ngritura dhe efektive.		
KONTEKSTI	VEPRIMET E PROPOZUARA	AKTERËT
SITUATA AKTUALE Dogana e Kosovës si edhe të gjitha administratat doganore në mbarë botën, tani veprojnë në rrethanat që paraqesin sfida për ta (u rrit fluksi i njerëzve, mallrave, parave dhe informacionit), si dhe të atyre zhvillimeve që sot për botën moderne përbëjnë rrezikun më të madh në fushat e sigurisë. Si një administratë moderne, Dogana e Kosovës duhet të jetë në gjendje për të rregulluar, kontrolluar dhe menaxhuar këto rreziqe në kufijtë tanë dhe në brendi të territorit. Konform kësaj DK, në vazhdimi reformohet dhe organizohet, duke i përcjellur trendët e zhvillimeve doganore ndërkombëtare. Ajo vazhdon së zbatuari standardet më të larta në kontrollin e importit, tranzitit dhe eksportit, duke siguruar efikasitetin e tregtisë së ligjshme.	1. Plotësimi i Udhëzimit Administrativ mbi organizimin e strukturës organizative. 2. Finalizimi i përshkrimit të vendeve të punës sipas SO bazuar në UA mbi organizimin e strukturës organizative.	MF, Dogana e Kosovës, DG TAXUD ICITAP, EXBS,

<p>Nga DK, janë ndërmarrë veprime konkrete organizative dhe menaxhuese që strukturat të jenë më fleksibile, plotësisht operacionale dhe të afta të parandalojnë aktivitetet e kundërligjshme.</p> <p>KËRKESAT DHE PRAKTIKAT E MIRA Të vazhdohet me ngritjen e kapaciteteve me qëllim që strukturat të jenë më fleksibile, plotësisht operacionale dhe të afta të parandalojnë aktivitetet e kundërligjshme ku bëhet ndarja adekuate e detyrave dhe përgjegjësive.</p>		
<p>VEPRIMI 1: Plotësimi i Udhëzimit Administrativ mbi organizimin e strukturës organizative.</p>		
<p>AKTIVITETET</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të formohet grupi punues për hartimin e UA mbi organizimin e strukturës organizative. • Të miratohet dhe zbatohet UA. 		
<p>PËRPARËSIA: E lartë.</p>		
<p>REZULTATI I PRITUR: Rritja e efektivitetit dhe efikasitetit në punë.</p>		
<p>TREGUESIT: Struktura e aprovuar dhe e vënë në zbatim.</p>		
<p>AUTORITETI PËRGJEGJËSE: MF, DK.</p>		
<p>AKTERËT E PËRFSHIRË: MF, Dogana e Kosovës.</p>		
<p>KOSTOT PËR GRUPET KRYESORE TË INTERESIT Autoriteti: DK. Kostot: Të parapara në buxhetin e autoritetit dhe donacione: 7,500.00 euro për 3 vite. Përfitimet: Strukturë doganore moderne dhe e profesionalizuar.</p>		
<p>KOHËZGJATJA: Në vazhdimësi</p>		
<p>KALENDARI I PROPOZUAR: Dhjetor 2016</p>		
<p>RREZIQET: Administrative.</p>		
<p>VEPRIMI 2; Finalizimi i përshkrimit të vendeve të punës sipas Strukturës Organizative bazuar në UA mbi organizimin e strukturës organizative</p>		
<p>AKTIVITETET</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të formohet grupi punues për finalizimin e përshkrimit të vendeve të punës • Të miratohet dhe zbatohen përshkrimet e vendeve të punës. 		
<p>PËRPARËSIA: E mesme.</p>		
<p>REZULTATI I PRITUR: Caktimi i detyrave dhe përgjegjësive.</p>		
<p>TREGUESIT: Përshkrimet e finalizuara dhe aprovuara</p>		
<p>AUTORITETI PËRGJEGJËSE: DK.</p>		
<p>AKTERËT E PËRFSHIRË: MF, Dogana e Kosovës.</p>		
<p>KOSTOT PËR GRUPET KRYESORE TË INTERESIT Autoriteti: DK. Kostot: Administrative Përfitimet: Strukturë doganore moderne dhe e profesionalizuar.</p>		

KOHËZGJATJA: Në vazhdimësi		
KALENDARI I PROPOZUAR: Dhjetor 2016		
RREZIQET: Administrative.		
OBJEKTIVI 2: Avancimi i sistemit menaxhues për të siguruar një sistem të qëndrueshëm për matjen e performancës konform Planit Strategjik të DK 2016-2018.		
TREGUESIT: Sistemi i ngritur dhe efektiv.		
KONTEKSTI	VEPRIMET E PROPOZUARA	AKTERËT
<p>SITUATA AKTUALE</p> <p>Plani Strategjik i Doganës së Kosovës është një dokument gjithpërfshirës i politikave doganore, i cili përmban misionin, vizionin, vlerat dhe objektivat strategjike për periudhën tre vjeqare 2016-2018. Drejtoritë qendrore dhe departamentet rajonale janë të përfshirë në mënyrë aktive në zhvillimin e strategjive efektive për të arritur misionin e Doganës dhe për të përmirësuar performancën e saj. Zbatimi i Planit Strategjik do të paraprihet me veprime konkrete dhe aktivitete, në përputhje me prioritetet e Qeverisë të parapara me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH), të miratuar nga Ministria e Financave për vitet 2016-2018. Plani Strategjik 2016-2018 adreson edhe rekomandimet për standardet e kërkuara nga udhërrëfyesi i BE-së për Doganën - Blueprint-i i BE-së, Raporti i Progresit, Marrëveshjet dhe deklaratat për funksionimin e administratave doganore, ligjet dhe direktivat nga DG TAXUD, si dhe dokumenteve të dala që përkrahin zhvillimin dhe modernizimin e administratave doganore.</p> <p>KËRKESAT DHE PRAKTIKAT E MIRA</p> <p>Zhvillimi i një sistemi efektiv dhe modern i cili përkrah matjen dhe arritjen e objektivave të parapara me Strategjinë 2016-2018.</p>	<p>1. Vlerësimi i implementimit të objektivave të planit strategjik të DK 2016-2018</p>	<p>DK</p>
VEPRIMI 1: Vlerësimi i implementimit të objektivave të planit strategjik të DK 2016-2018		
AKTIVITETET		
<ul style="list-style-type: none"> • Të bëhet vlerësimi në baza tre mujore rreth performancës • Të përgatitet raporti ku identifikohen plotësimi dhe ngecja e objektivave 		
PËRPARËSIA E lartë.		
REZULTATI I PRITUR		
<ul style="list-style-type: none"> • Ngritja e performancës së DK në nivel të përgjithshëm, si rrjedhojë e përmbushjes së objektivave të planit strategjik 2016-2018 		

TREGUESIT		
<ul style="list-style-type: none"> • Përmirësimi i mëtejshëm i sistemit të tanishëm për mbledhjen e të hyrave në kufi (detyrimet doganore, akciza dhe TVSH) • Përmirësimi i aftësive operative të doganës në zbulimin e formave të ndryshme të tregtisë ilegale dhe importin e mallrave të ndaluara. • Raportimi në baza mujore për mbledhjen e të hyrave dhe zbulimin e formave të ndryshme të tregtisë ilegale dhe mallrave të ndaluara. 		
AUTORITETI PËRGJEGJËSE : Dogana e Kosovës.		
AKTERËT E PËRFSHIRË : DK		
KOSTOT PËR GRUPET KRYESORE TË INTERESIT		
Autoriteti : DK.		
Kostot : Të parapara në buxhetin e autoritetit: 3.000 euro për 3 vite.		
Përfitimet : Performanca e përgjithshme e ngritur e DK.		
KOHËZGJATJA : Në vazhdimësi.		
KALENDARI I PROPOZUAR : Në vazhdimësi		
RREZIQET Ndryshimet e politikave fiskale		
OBJEKTIVI 3 . Ngritja e vetëdijësimit në parandalimin e sjelljeve jo etike dhe korrupsionit dhe eliminimin e konfliktit të interesit		
TREGUESIT : Zbatimi praktik i Kodit Etik dhe legjisllacionit ekzistues.		
KONTEKSTI	VEPRIMET E PROPOZUARA	AKTERET
<p>SITUATA AKTUALE</p> <p>Dogana e Kosovës ka bërë përpjekje në vazhdimësi që të rrisë kapacitetet në parandalimin e sjelljeve jo etike dhe korruptive duke krijuar mekanizma adekuat në luftë kundër këtyre dukurive. Në vazhdimësi ka ndërmarrë fushata të vetëdijësimit për zyrtarët e saj kundër korrupsionit si dhe vetëdijësimin e qytetarëve dhe bizneseve për të drejtat e tyre dhe raportimin e korrupsionit.</p> <p>KËRKESAT DHE PRAKTIKAT E MIRA</p> <p>Të ndërmerren hapa drejt zhvillimit dhe avancimit të procedurave të cilat sigurojnë se i gjithë stafi mbështet sundimin e ligjit dhe i kryen detyrat e veta në mënyrë të drejtë, të pa anshme, të ndershme, në mirëbesim, me mirësjellje dhe në mënyrë profesionale dhe të vendosur.</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Ngritja e vetëdijësimit për zyrtarët doganor për pasojat e sjelljeve joetike dhe korrupsionit. 2. Ngritja e vetëdijësimit për qytetarët dhe bizneset në parandalimin e korrupsionit 3. Ndërmarrja e vizitave inspektuese ad-hok dhe të planifikuara mbi zbatimin e planit anti-korrupsion. 	<p>MF, Dogana e Kosovës,</p> <p>Autoriteti Kundër Korrupsionit, EXBS</p>
VEPRIMI 1 . Ngritja e vetëdijësimit për zyrtarët doganor për pasojat e sjelljeve joetike dhe korrupsionit .		

<p>AKTIVITETET: Të përgatitet plani për veprim Të aprovohet nga Drejtori i Përgjithshëm Të zbatohet plani i veprimit</p>
<p>PËRPARËSIA: E lartë.</p>
<p>REZULTATI I PRITUR: Rritja e numrit të informatave të raportuara për rastet e korrupsionit nga ana e qytetarëve dhe bizneseve.</p>
<p>TREGUESIT: Zbulimi i rasteve të dyshuara me korrupsion, si rrjedhojë e informatave të pranuar.</p>
<p>AUTORITETI PËRGJEGJËSE: Dogana e Kosovës.</p>
<p>AKTERËT E PËRFSHIRË: MF, DK, AKK, EXBS</p>
<p>KOSTOT PËR GRUPET KRYESORE TË INTERESIT Autoriteti: DK. Kostot: Të parapara në buxhetin e autoritetit: 9,000 euro për 3 vite Përfitimet: Strukturë e profesionalizuar në fushën e zbatimit të ligjit dhe parimeve etike dhe profesionale</p>
<p>KOHËZGJATJA: Në vazhdimësi.</p>
<p>KALENDARI I PROPOZUAR: Në vazhdimësi.</p>
<p>REZIQET: Mos zbatimi i Kodit Etik nga ana e zyrtarëve doganor</p>
<p>VEPRIMI 2. Ngritja e vetëdijësisimit për qytetarët dhe bizneset në parandalimin e rasteve korruptive</p>
<p>AKTIVITETET:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Organizimi i fushatave mediale vetëdijësuese nga ana e DK, për qytetarët dhe bizneset • Organizimi i tryezave të rrumbullakta me Biznese dhe qytetarë me qëllim diskutimin e korrupsionit të mundshëm në DK • Promovimi i linjës HOTLINE, për raportimin e rasteve korruptive
<p>PËRPARËSIA: E lartë.</p>
<p>REZULTATI I PRITUR: Rritja e numrit të informatave të raportuara për rastet e dyshuara tekorrupsionit nga ana e qytetarëve dhe bizneseve</p>
<p>TREGUESIT: Rritja e rasteve të dyshuara me korrupsion, si rrjedhojë e vetëdijësisimit të qytetarëve dhe bizneseve</p>
<p>PËRPARËSIA: E lartë</p>
<p>AUTORITETI PËRGJEGJËSE: Dogana e Kosovës.</p>
<p>AKTERËT E PËRFSHIRË: MF, DK, AKK</p>
<p>KOSTOT PËR GRUPET KRYESORE TË INTERESIT Autoriteti: DK. Kostot: Të parapara në buxhetin e autoritetit: 9,000 euro për 3 vite Përfitimet: Strukturë e profesionalizuar në fushën e zbatimit të ligjit dhe parimeve etike dhe profesionale</p>
<p>KOHËZGJATJA: Në vazhdimësi.</p>
<p>KALENDARI I PROPOZUAR: Në vazhdimësi.</p>
<p>RREZIQET: Hezitimi i qytetarëve dhe bizneseve për raportimin e rasteve korruptive</p>
<p>KOHËZGJATJA Në vazhdimësi.</p>
<p>KALENDARI I PROPOZUAR: Dhjetor 2016</p>
<p>RREZIQET: Mungesa e mjeteve buxhetore dhe pengesat e ndryshme administrative.</p>

VEPRIMI I 3: Ndërmarrja e vizitave inspektuese ad-hoc dhe të planifikuara mbi zbatimin e planit anti-korrupsion.		
AKTIVITETET:		
<ul style="list-style-type: none"> • Të përgatitet një plan rreth vizitave ad-hoc • Të zabtohet plani i vizitave ad-hoc • Përplilimi i raportit me të gjeturat e vizitës ad-hoc, dhe njoftimi i menaxhmentit të DK. 		
PËRPARËSIA: E lartë.		
REZULTATI I PRITUR: Sigurimi se parimi etik aplikohet në praktikë		
TREGUESIT: Projekti dhe plani i veprimit të përpiluar dhe vëna në zbatim.		
AUTORITETI PËRGJEGJËS: Dogana e Kosovës.		
AKTERËT E PËRFSHIRË: Sektori i standardeve profesionale		
KOSTOT PËR GRUPET KRYESORE TË INTERESIT		
Autoriteti: DK.		
Kostot: Të parapara në buxhetin e autoritetsë: 3,000 euro për 3 vite.		
Përfitimet: Strukturë e profesionalizuar në fushën e zbatimit të ligjit dhe parimeve etike dhe profesionale bazuar në standardet evropiane dhe praktikrat e mira.		
KOHËZGJATJA: Në vazhdimësi.		
KALENDARI I PROPOZUAR: Në vazhdimësi.		
RREZIQET: Pengesat e ndryshme administrative.		
PROCEDURAT		
OBJEKTIVI 1: Lehtësimit dhe thjeshtëzimit i procedurave doganore		
TREGUESIT: Avancimi i procedurave të thjeshtësuara doganore sipas konceptit paperless		
KONTEKSTI	VEPRIMET E PROPOZUARA	AKTERËT
SITUATA AKTUALE Dogana e Kosovës, me qëllim të lehtësimit dhe thjeshtëzimit të procedurave doganore, aplikon një varg të procedurave me ndikim ekonomik si: Depo Doganore, procedura të thjeshtëzuara, përpunim i brendshëm, përpunim nën mbikqyrje doganore, import të përkohshëm, etj. Sidoqoftë me qëllim të përmirësimit të mëtutjeshëm të procedurave dhe lehtësimin e tregtisë, si dhe kërkesave që shfaqen nga bizneset, bëjnë që udhëzimet që janë në fuqi dhe që i rregullojnë bazën ligjore për këto procedura të rishikohen dhe konform nevojave të shfaqura të rishikohen. Dogana e Kosovës gjithashtu ka automatizuar në masë të madhe një pjesë të këtyre procedurave me ndikim ekonomik, duke i lehtësuar procedurat si për biznesin ashtu edhe për zyrtarët doganor. Një lehtësim tjetër paraqet edhe prezantimi i kanalit blu, përmes së cilit kompanitë që gëzojnë	<ol style="list-style-type: none"> 1. Rishikimi i UA, për procedurat e thjeshtëzuara në import dhe eksport të mallrave 2. Krijimi i modulit/sistemit për Kontrollin e Lëvizjeve të Mallrave Akcizore (EMCS) si dhe krijimi i modulit / sistemit për Regjistrimin dhe Identifikimin e Bizneseve (EORI/AEO) 3. Zhvillimi i sistemit për Menaxhim të Dokumenteve. 	DK, ICITAP, EXBS, IPA.

historiat të pastër dhe i plotësojnë disa kriterë të parapara kalojnë nëpër procedura doganore pa kontrolle fizike të mallrave. Vlen të potencohet se Dogana e Kosovës është e vetmja administratë doganore në rajon e cila me sukses implementon konceptin “paperless” që nga viti 2015.

KËRKESAT DHE PRAKTIKAT E MIRA

Zbatimi i standardeve dhe praktikave ndërkombëtare rreth lehtësimit dhe thjeshtëzimit të procedurave doganore.

VEPRIMI 1: Rishikimi i UA për procedurat e thjeshtëzuara në import dhe eksport të mallrave.

AKTIVITETET:

1. Të analizohet situata aktuale.
2. Të formohet grupi punues për rishikimin e UA për procedura të thjeshtëzuara
3. Të draftohet UA për procedurat e thjeshtëzuara
4. Të miratohet nga DP.

PËRPARËSIA: E lartë.

REZULTATI I PRITUR: UA i ri i miratuar dhe fuqizuar.

TREGUESIT:

Implementimi i procedurave të avancuara.
Lehtësim i shkëmbimeve tregtare dhe lëvizjes së mjeteve.
Rritja e cilësisë së kontrollit dhe respektim i procedurave

AUTORITETI PËRGJEGJËS: Dogana e Kosovës.

